



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR
INSPEKTIMIN NË LIDHJE ME ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL

KËSHILLI I QARKUT DURRËS

Tiranë, Korrik 2015

RAPORT

Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në institucionin, Këshilli i Qarkut Durrës

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka rënë në dijeni të faktit se Këshilli i Qarkut Durrës, me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës” ka kryer procesin e ristrukturimit të institucionit. Si rrjedhojë e pakësimit të ndjeshëm të fondeve financiare në buxhet, procesi i ristrukturimit do pasqyrohej në reduktimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Qarkut Durrës, duke vendosur lirimin e disa prej tyre nga shërbimi civil.

Në kushtet kur verifikimi i këtij procesi, ka lidhje me një sërë institutesh të tjera të ligjit për nëpunësin civil, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështjete të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me Vendimin Nr. 41, datë 24.04.2015, “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Durrës”, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në këtë institucion, të orientuar në të gjitha aspektet që rregullon ligji për nëpunësin civil, duke u kujdesur që të trajtohet hollësisht edhe procedura e ristrukturimit të institucionit.

Në zbatim të Vendimin Nr. 41, datë 24.04.2015, “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Durrës”, u ngrit grupi i inspektimit, i përbërë nga inspektorët Alda Xhaxhiu dhe Gentiana Biku, të cilët kanë bërë përpunimin e të dhënave dhe përgatitën projektraportin e inspektimit për këtë institucion, i cili iu dërgua për njohje Këshillit të Qarkut Durrës, me shkresën nr. 337/3 prot., datë 30.07.2015, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet. Pas kësaj, projekt raporti është nënshkruar pa vërejtje nga Kryetari i Qarkut Durrës dhe Drejtori përkatës, duke shprehur vlerësimin e tyre për punën e kryer.

Qëllimi i inspektimit:

- Mbikëqyrja, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”;
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara e të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil;
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë detyrat dhe rekomandimet përkatëse për

përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Objekti i inspektimit:

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit Civil”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.).
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Nëpunësit që janë mbajtur pas ristrukturimit, në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe).

7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm të disiplinës).
10. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, referuar Kreut XII, “Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
11. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Metodologjia e inspektimit

Inspektimi përfshiu zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me respektimin e kërkesave ligjore në procesin e deklarimit të statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, verifikimin e procesit të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Durrës, praktikën e lirimt nga shërbimi civil të nëpunësve që i është suprimuar pozicioni i punës apo i janë ndryshuar kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme, për shkak të ristrukturimit të institucionit, bazuar në ndryshimet strukturore të miratuara me Vendimin e Këshillit të Qarkut Durrës me nr.2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës”, masat disiplinore, etj.

Në zbatim të programit dhe drejtimit të inspektimit të përcaktuar në Vendimin nr. 41, datë 24.04.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, grupi i inspektimit verifikoi dhe shqyrtoi dokumentacionin nëpërmjet këqyrjes së materialeve të administruara në dosjet e personelit dhe në arkivën e institucionit.

- U verifikuan të gjitha pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe 4 strukturave të institucionit për periudhën 2013-2015;
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër, të kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil;
- U verifikua nëse përshkrimet edhe vlerësimet individuale të punës për pozicionet pjesë të shërbimit civil, janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar;
- U verifikuan të dhënat profesionale si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si arsimit, përvoja në punë e të tjera;
- Aktet që materializojnë ndryshimet strukturore:
 - Vendimi nr. 2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës”.
 - Vendimi nr. 16, datë 03.05.2013 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 153, datë 10.02.2012 të strukturës organizative të administratës të Këshillit të Qarkut Durrës”.

- Vendimi nr. 6, datë 17.03.2014 “Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës të Këshillit të Qarkut Durrës”.
- Vendimi nr. 41, datë 17.10.2014 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 6, datë 17.03.2014 të Këshillit të Qarkut “Për disa ndryshime në strukturë organizative të Administratës të Këshillit të Qarkut Durrës”.
- Vendimi nr. 7, datë 11.02.2015 i Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Durrës “Për Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit”.
- Rregullorja e Funkcionimit të Brendshëm të Administratës së Këshillit të Qarkut të Durrës, miratuar me Vendimin nr. 4, datë 30.01.2015.
- Shkresa e Prefektit të Qarkut Durrës me nr. 200/2prot., datë 09.02.2015, për konfirmimin e bazueshmërisë ligjore të vendimit nr. 2, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Durrës.
- Shkresa e Prefektit të Qarkut Durrës me nr. 422/1prot., datë 14.05.2013, për konfirmimin e bazueshmërisë ligjore të Vendimit nr. 16, datë 03.05.2013 të Këshillit të Qarkut Durrës.
- Shkresa e Prefektit të Qarkut Durrës me nr. 375/1prot., datë 27.03.2014, për konfirmimin e bazueshmërisë ligjore të Vendimit nr. 6, datë 17.03.2014 të Këshillit të Qarkut Durrës.
- Shkresa e Prefektit të Qarkut Durrës me nr. 1503/10prot., datë 27.10.2014, për konfirmimin e bazueshmërisë ligjore të Vendimit nr. 41, datë 17.10.2014 të Këshillit të Qarkut Durrës.
- Listëpagesat e muajit shkurt 2014 të të gjithë punonjësve të institucionit.
- Listëpagesat e muajit prill 2015 të të gjithë punonjësve të institucionit, si dhe materiale të tjera që kanë lidhje me procesin e inspektimit.

Konstatimet e inspektimit janë të materializuara si anekse më vete, në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij projektraporti simë poshtë:

- *Aneksi 1 - “Respektimi i kërkesave të përgjithëshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion.*
- *Aneksi 2 - “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të punësuar nëpërmjet konkurimit (data 26.02.2014)”.*
- *Aneksi 3 - “Organigrama dhe historiku i marrëdhënies me shërbimin civil të punonjësve të Këshillit të Qarkut Durrës”.*

Përmbajtja e raportit:

- I. **Deklarimi i statusit të punësimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.**
 1. Strukturimi i institucionit dhe ndarja e pozicioneve të punës në momentin e inspektimit.

Ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendos rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij. Në nenin 2 të tij, përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, por njëkohësisht evidentohen dhe rastet përjashtimore për disa funksione të identifikuara shprehimisht në këtë dispozitë.

Këshilli i Qarkut Durrës është krijuar dhe funksionon si organ përfaqësues i Qarkut, mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004, i cili në nenet 5 dhe 6 të tij, e përcakton atë si njësi të qeverisjes vendore, e për këtë arsye ky institucion përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Administrata e Këshillit të Qarkut funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Qarkut, sipas parashikimeve të nenit 54 të ligjit 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut.

Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në datën 26.02.2014, Këshilli i Qarkut Durrës ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 16, datë 03.05.2013 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 153, datë 10.02.2012 të strukturës organizative të administratës të Këshillit të Qarkut Durrës”.

Subjekti i inspektimit, aktualisht, funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr.2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës” dhe rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës së Këshillit të Qarkut të Durrës”, të miratuar me vendimin nr. 4, datë 30.01.2015 të Këshillit të Qarkut Durrës. Rregullorja e mësipërme është bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; ligji nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Kjo rregullore ka përcaktuar misionin e Këshillit të Qarkut Durrës dhe ka përcaktuar se si të bëhet vlerësimi i pozicioneve të mbetura në kushtet aktuale në përputhje me detyrat e përgjegjësitë e reja; detyrat funksionale të sektorëve dhe nëpunësve të tyre.

Nisur nga klasifikimi i pozicionevetë shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe VKM nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, sipas strukturës së fundit, të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës”, rezulton se administrata e Këshillit të Qarkut Durrës ka gjithsej **33** pozicione pune, nga të cilat **23** pozicione pune, janë pjesë e shërbimit civil dhe **10** pozicione pune janë të karakterit mbështetës, marrëdhëniet e punës së të cilëve, rregullohen prej Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë. E përshkruar sipas nivelit të nëpunësisë, gjëndja paraqitet si vijon:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, rezulton të jenë **2** pozicione, që i përkasin nivelit “Drejtor”.

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **5** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “Përgjegjës sektori/ Kryeinspektor”.
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv janë **16** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “specialist/inspektor”.

Konkluzion:

Nisur nga funksionet e çdo pozicioni pune që është përfshirë në shërbimin civil, duke u bazuar në Rregulloren e Brendshme të institucionit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se është bërë një ndarje e drejtë si ndërmjet funksioneve drejtuese dhe atyre ekzekutive ashtu edhe midis pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, me ato që kryejnë funksione administrative të karakterit mbështetës.

2. Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67 i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që institucioni i Këshillit të Qarkut Durrës përfshihet në fushën e shërbimit civil, deklarimi i statusit të punësimit për çdo nëpunës, që në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit ka qenë i punësuar në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe konkretisht të nenit 67, pikat 3,4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues”, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;
- pika 4, “Nëpunës ekzistues”, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji;
- pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit”, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit.

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, pika 1, është përcaktuar se: “Nëpunës civilë”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Këto janë dispozitat bazë që duhet të mbajë parasysh njësia përgjegjëse, për të realizuar drejt detyrimin ligjor të deklarimit të statusit të punësimit.

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me faktin nëse veprimet e kësaj njësie janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, verifikoi dhe

analizoi materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, sidomos organigramën dhe strukturën analitike të institucionit, që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit (miratuar me Vendimin nr. 16, datë 03.05.2013 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 153, datë 10.02.2012 të strukturës organizative të administratës të Këshillit të Qarkut Durrës”) procedurën e rekrutimit për secilin nëpunës si dhe të dhënat personale.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstatoi se procedura e deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësit e Këshillit të Qarkut Durrës, është kryer duke mos ju referuar strukturës së mësipërme, që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, por organigramës dhe strukturës analitike të institucionit të miratuar pas fillimit të efekteve të ligjit në fjalë, me Vendimin nr. 6, datë 17.03.2014, “Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”.

Konstatohet se Komisioni i Ristrukturimit është ngritur rregullisht, me Urdhrin nr. 52, datë 02.04.2014 “Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit”, në përputhje me kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”; Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” dhe Udhëzimit nr.3, datë 14.04.2014 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit” të Departamentit të Administratës Publike, të cilat e kanë vendosur këtë hallkë, në krye të procesit të ristrukturimit, për tu kujdesur edhe në drejtim të anës procedurale ligjore.

Por nga pikpamja e përmbajtjes së veprimtarisë së Komisionit të Ristrukturimit vërehet se ka zbatim të gabuar të ligjit material të aplikuar në momentin e përgatitjes së propozimeve që i janë bërë njësisë përgjegjëse. Aktet e përpiluara në këtë kuadër, pa të drejtë kanë përdorur si bazë ligjore Kodin e Punës dhe jo dispozitat që rregullojnë këtë aspekt të menaxhimit të shërbimit civil.

Si rrjedhojë, janë liruar nga shërbimi civil nëpunës pa u bërë më parë deklarimi i statusit të punësimit, edhe pse nëpunësit që u përfshinë në procesin e ristrukturimit kishin qenë të emëruar me procedura të rregullta konkurimi, konform ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë skematike strukturën organizative të miratuar me Vendimin nr. 16, datë 03.05.2013, strukturë me të cilën, Këshilli i Qarkut Durrës ka funksionuar në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në datën 26.02.2014, dhe strukturën organizative të miratuar me nr. 6, datë 17.03.2014 “Për disa ndryshime në strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Durrës”, pra në momentin kur njësia përgjegjëse ka bërë deklarimin e statusit të punësimit të nëpunësve civil.

- Struktura e miratuar me Vendimin nr. 16, datë 03.05.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 153, datë 10.02.2012 të strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”

Struktura e administratës së Këshillit të Qarkut Durrës miratuar me vendimin e mësipërm, kishte në përbërje të saj **63** punonjës, nga të cilët **48** pozicione, përfshiheshin në fushën e shërbimit civil dhe pjesa tjetër përbëhej nga punonjës mbështetës, jashtë shërbimit civil.

Struktura e nëpunësve civile të institucionit kishte organizimin e mëposhtëm:

- I. Drejtoria e Koordinimit të Politikave të Qarkut
 - Drejtor 1
 - Sektori i Koordinimit, Hartimit dhe Zbatimit të Projekteve me organikë përgjegjës sektori 1
 - specialistë 6
 - Sektori i Turizmit, Kulturës dhe Mbrojtjes së Mjedisit përgjegjës sektori 1
 - specialistë 4

- II. Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Juridike
 - Drejtor 1
 - Sektori i Financës me organikë përgjegjës sektori 1
 - specialistë 2
 - Sektori i Shërbimeve Juridike me organikë përgjegjës sektori 1
 - specialistë 2

- III. Drejtoria e Burimeve Njerëzore
 - Drejtor 1
 - Sektori i Personelit, Arshivës dhe Shërbimeve të Administratës përgjegjës sektori 1
 - specialist 1
 - Sektori i IT-së dhe Statistikës përgjegjës sektori 1
 - specialistë 3

- IV. Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Shërbimeve Rajonale
 - Drejtor 1
 - Sektori i Urbanistikës, përgjegjës sektori 1
 - specialistë 3
 - Sektori i Shërbimeve Rajonale përgjegjës sektori 1
 - specialistë 2

- V. Sektori i Auditit të Brendshëm
 - Specialistë 2

- VI. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës
 - Drejtor,
 - Sektori i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës,

përgjegjës sektori	1
specialistë	3
-Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës	
kryeinspektor	1
inspektorë	2

Totali

48 nëpunës civil

- Struktura e miratuar me Vendimin nr. 6, datë 17.03.2014 “Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”

Me ndryshimet që iu bënë strukturës me vendimin nr. 6, datë 17.03.2014 të Këshillit të Qarkut Durrës, përbërja e administratës u reduktua, nga 63 punonjës që ishin sipas strukturës së mëparshme, në **52** punonjës, nga të cilët vetëm **39** pozicione, përfshiheshin në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil (siç shihet kemi pakësim dhe në numrin e nëpunësve civile, nga 48 në 39).

Struktura e nëpunësve civile të institucionit kishte organizimin e mëposhtëm:

- I. Drejtoria e Koordinimit të Politikave të Qarkut

Drejtor	1
- Sektori i Koordinimit, Hartimit dhe Zbatimit të Projekteve	
përgjegjës sektori	1
specialistë	2
- Sektori i Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Mjedisit	
përgjegjës sektori	1
specialistë	2

- II. Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve

Drejtor	1
- Sektori i Financës	
përgjegjës sektori	1
specialistë	2
- Sektori i Shërbimeve Juridike	
përgjegjës sektori	1
specialistë	2
- Sektori i Shërbimeve Rajonale	
përgjegjës sektori	1
specialistë	2

- III. Drejtoria e Burimeve Njerëzore
- IV. Drejtor

Drejtor	1
- Sektori i Personelit dhe Arshivës	
përgjegjës sektori	1
specialist	1
- Sektori i IT-së dhe Statistikës	
përgjegjës sektori	1
specialistë	1

V.	Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Drejtor	1
	- Sektori i Urbanistikës, përgjegjës sektori	1
	specialistë	3
	- Sektori i Turizmit dhe Kulturës përgjegjës sektori	1
	specialistë	2
VI.	Auditii Brendshëm specialist	1
VII.	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Drejtor	1
	- Sektori i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, përgjegjës sektori	1
	specialist	3
	- Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës përgjegjës sektori	1
	(<i>kryeinspektor</i>) inspektorë	2

Totali

39 nëpunës civil

Sqarojmë se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në datën 26.02.2014, deklarimi i statusit të punësimit në Këshilline Qarkut Durrës, në mënyrë skematike paraqitet si më poshtë:

- **14** nëpunës civil
- **13** nëpunës civil në periudhë prove
- **2** mos deklarime të statusit të punësimit
- **2** nëpunës kanë dhënë dorëheqjen me dëshirë
- **8** pozicione vakante

Gjithashtu, sqarojmë se në këtë periudhë janë marrë 6 persona me kontratë të përkohshme dhe më pas janë zhvilluar procedurat e rekrutimit të pasqyruara këto në mënyrë të detajuar në aneksin nr. 2. Kurse 2 pozicione pune të tjera janë quajtur vende vakante.

Pra, në total, kemi gjithsej 39 pozicione pune në shërbimin civil

► Në vijim të sa më sipër, njësia përgjegjëse nuk është shprehur për statusin e punësimit për **17** nëpunës civil, duke urdhëruar lirin nga detyra, pa ju deklaruar më parë statusi i punësimit edhe pse këta nëpunës civil që u përfshinë në procesin e ristrukturimit kanë qenë të emëruar me procedura të rregullta konkurimi, konform ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”. Për të gjithë këta nëpunës civil nga ana e Komisionit të Ristrukturimit është përdorur motivacioni “pamundësi për tu transferuar”, dhe bazë ligjore Kodi i Punës në një kohë kur nga ndryshimet strukturore vetëm 9 pozicione janë shkurtuar.

1. *****, në pozicionin “*Specialist i Koordinimit, Hartimit dhe Zbatimit të Projekteve*”, emëruar në shërbimin civil me urdhrin nr.130, datë 12.12.2008 “*Për emërim në detyrë*”,liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 58, datë 11.04.2014 “*Për lirim nga detyra të ******”.
2. *****, në pozicionin “*Specialist i Koordinimit, Hartimit dhe Zbatimit të Projekteve*”, emëruar me urdhrin nr. 71, datë 03.06.2013 “*Për emërim në detyrë*”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 66, datë 11.04.2014 “*Për lirim nga detyra të ******”.
3. *****, në pozicionin “*Specialist i Koordinimit, Hartimit dhe Zbatimit të Projekteve*”emëruar me urdhrin nr. 72, datë 03.06.2013 “*Për emërim në detyrë, në periudhë prove*”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 60, datë 11.04.2014 “*Për lirim nga detyra të ******”.
4. *****, në pozicionin “*Specialist i Koordinimit, Hartimit dhe Zbatimit të Projekteve*”,emëruar me urdhrin nr. 11/4, datë 08.02.2010 “*Për emërim në detyrë*”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 62, datë 11.04.2014 “*Për lirim nga detyra të ******”.
5. *****, në pozicionin “*Specialist i Turizmit, Kulturës dhe Mbrojtjes së Mjedisit*”, emëruar me urdhrin nr. 12/4, datë 08.02.2010 “*Për emërim në detyrë*”, liruar nga shërbimi civil me Urdhrin nr. 65, datë 11.04.2014 “*Për lirim nga detyra të ******”.
6. *****, në pozicionin “*Specialist i Turizmit, Kulturës dhe Mbrojtjes së Mjedisit*”, emëruar me urdhrin nr. 37/1, datë 20.06.2011.2010 “*Për emërim në detyrë*”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 78, datë 23.04.2014 “*Për lirim nga detyra të ******”.
7. *****, në pozicionin “*Specialist i Turizmit, Kulturës dhe Mbrojtjes së Mjedisit*”emëruar me urdhrin nr. 74, datë 03.06.2013 “*Për emërim në detyrë*”, liruar nga shërbimi civil me urdhër nr. 84, datë 30.04.2014 “*Për lirim nga detyra të ******”.
8. *****, në pozicionin “*Specialist i IT-së dhe Statistikës*”, emëruar me vendimin nr. 12, datë 31.05.2013 “*Për përzgjedhjen e kandidatit fitues pas konkursit për një vend të lire pune*”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 64, datë 11.04.2014 “*Për lirim nga detyra të ******”.
9. *****, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Urbanistikës*”, emëruar me urdhrin nr. 75, datë 03.06.2013 “*Për emërim në detyrë*”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 59, datë 11.04.2014 “*Për lirim nga detyra të ******”.
10. *****, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Urbanistikës*”, emëruar me urdhrin nr. 67, datë 03.06.2013 “*Për emërim në detyrë*”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 143, datë 06.12.2013 “*Për lirim nga detyra të ******”.
11. *****, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Shërbimeve Rajonale*”, emëruar me urdhrin nr. 70, datë 03.06.2013 “*Për emërim në detyrë*”, liruar nga

shërbimi civil me urdhrin nr. 63, datë 11.04.2014 “Për lirim nga detyra
*****”.

12. *****, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Auditimit të Brëndshëm”, emëruar me urdhrin nr. 47, datë 06.05.2013 “Për marrjen në punë me kontratë 3-mujore provizore”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 85, datë 30.04.2014 “Për lirim nga detyra të *****”.
13. *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës” emëruar me urdhrin nr. 20, datë 29.01.2008 “Për emërim në detyrë”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 68, datë 16.04.2014 “Për lirim nga detyra të *****”.
14. *****, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës” emëruar me urdhrin nr. 12/2, datë 29.01.2010 “Për emërim në detyrë”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 77, datë 23.04.2014 “Për lirim nga detyra të *****”.
15. *****, në pozicionin “Inspektornë Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës”, emëruar me urdhrin nr. 11/2, datë 29.01.2010 “Për emërim në detyrë”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 61, datë 11.04.2014 “Për lirim nga detyra të *****”.
16. *****, në pozicionin “Inspektornë Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës”, emëruar me urdhrin nr. 12/1, datë 29.01.2010 “Për emërim në detyrë”, liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 72, datë 18.04.2014 “Për lirim nga detyra të *****”.
17. *****, në pozicionin “Specialist në Sektorin e AMT” emëruar me urdhrin nr. 60, datë 19.09.2011 dhe liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 73, datë 18.04.2014 “Për lirim nga detyra të *****”.

► Në përfundim të kësaj analize, statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni, sipas strukturës së miratuar me Vendimin nr. 16, datë 03.05.2015 që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e kategorizojmë në këtë mënyrë:

2/a. Nëpunësit të cilëve i është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë e nëpunësve civilë të konfirmuar.

Nisur nga verifikimi i akteve të deklaramit të statusit të punësimit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, punonjësit që kanë fituar statusin e nëpunësit civil sipas kërkesave të pikës 3 të nenit 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe pikës 1 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, janë nëpunësit e mëposhtëm:

1. *****, në pozicionin “Drejtor nëDrejtorinë e Koordinimit të Politikave të Qarkut”
2. *****, në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Kordinimit, Hartimit dhe Zbatimit të Projekteve”
3. *****, në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Kordinimit, Hartimitdhe Zbatimit të Projekteve”
4. *****, në pozicionin “Specialiste/Inspektore në IMT”
5. *****, në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Financës”
6. *****, në pozicionin “Specialist për Auditimi”
7. *****, në pozicionin “Specialist në Sektorin e AMT”
8. *****, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Urbanistikës”
9. *****, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Urbanistikës”
10. *****, në pozicionin “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun”
11. *****, në pozicionin “Specialiste e menaxhimit të të Ardhurave”
12. *****, në pozicionin “Specialiste e Menaxhimit të Shpenzimeve”
13. *****, në pozicionin “Specialiste për Administrimin e Regjistrin të Territorit”
14. *****, në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Shërbimeve Juridike”

2/b. Nëpunësit të cilëve i është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë e nëpunësve civilë në periudhë prove.

Nisur nga verifikimi i akteve të deklaramit të statusit të punësimit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, punonjësit që kanë fituar statusin e “nëpunësit civil në periudhëprove”, sipas kërkesave të pikës 4, të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, janë si më poshtë:

1. *****, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”
2. *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektorinë Sektorin e Personelit, Arshivës dhe Shërbimeve të Administratës”
3. *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektorinë Sektorin e Shërbimeve Juridike”
4. *****, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Shërbimeve Rajonale”
5. *****, në pozicionin “Përgjegjës sektori në Sektorin e Shërbimeve Rajonale”
6. *****, në pozicionin “Drejtor i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”
7. *****, në pozicionin “Specialiste e Arshivës Digitale”
8. *****, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Rajonale”
9. *****, në pozicionin “Specialist i Marrëdhënieve me Gjqësorin”
10. *****, në pozicionin “Kryeinspektor/Përgjegjës në IMT”
11. *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori i Sektorit të IT dhe Statistikës”
12. *****, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Juridike”
13. *****, në pozicionin “Specialiste Mjedisi në Sektorin e Urbanistikës”

2/c. Nëpunës të cilëve nuk iu është deklaruar statusi i punësimit.

► Konstatohet se në disa raste, pavarësisht faktit se momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit (data 26.02.2014) i ka gjetur në pozicione pune të shërbimit civil dhe që njëkohësisht i plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk është shprehur për statusin e punësimit, konkretisht:

1. *****, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Turizmit, Kulturës dhe Mbrojtjes së Mjedisit” (sqaruar në mënyrë të detajuar në faqen 23).
2. *****, në pozicionin “Specialist në Sektorin e IT-së dhe Statistikës” (sqaruar në mënyrë të detajuar në faqen 24).

• Në dy raste nëpunësit kanë dhënë dorëheqje nga detyra, si më poshtë:

1. *****, nga pozicioni “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Turizmit, Kulturës dhe Mbrojtjes së Mjedisit”; kërkesë për dorëheqje me nr. 286 prot., datë 27.02.2014 dhe vendimi i titullarit nr. 8, datë 05.03.2014 “Për lirim të *****”
2. *****, nga pozicioni “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Urbanistikës”; kërkesë për dorëheqje me nr. 467 prot., datë 08.04.2014 dhe vendimi i titullarit nr. 13, datë 17.04.2014 “Për lirim të *****”(sqaruar hollësisht në faqen 26).

Konkluzion:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe konkretisht të nenit 67, pikat 3, 4 dhe 6, për të gjitha sa analizuam me sipër (nënndarja “a” dhe “b”), konstaton se njësia përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në rastin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunësi civil dhe si nëpunësi civil në periudhë prove. Për shkak se, deklaratimet e statusit të punësimit duhet të ishin bërë sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 16, datë 03.05.2013, strukturë me të cilën, Këshilli i Qarkut Durrës ka funksionuar në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në datën 26.02.2014, dhe jo sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr.6, datë 17.03.2014 “Për disa ndryshime në strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Durrës”.

Ndërsa në rastin (nënndarja “c”), kur njësia përgjegjëse nuk është shprehur për statusin e punësimit, kërkohet të vijojë puna me procesin e verifikimit të statusit të punësimit dhe më tej të konfirmohet pozicioni i tyre në raport me sistemin e shërbimit civil. Ky veprim bën të mundur qartësimin e situatës së tyre në lidhje me proceset e administrimit të shërbimit civil, si procesi i rekrutimit, i ristrukturimit, vlerësimit të punës, zhvillimit të karrierës, etj.

II. Transferimi në shërbimin civil në rastin e ristrukturimit të institucionit, sipas nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”

Këshilli i Qarkut Durrës ka kaluar disa herë në proces ristrukturimi, si para ashtu edhe pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, gjë e cila ka sjellë edhe vështirësi në administrimin e shërbimit civil.

Në rast të ristrukturimit të institucionit, njësia e burimeve njerëzore, që është mekanizmi i ngarkuar me përgatitjen e kushteve që ky proces të zhvillohet në rrugën e duhur, duhet të njohë e të mbajë parasysh rradhën e punës që duhet ndjekur gjatë këtij procesi, e cila garanton një proces të rregullt administrativ.

Nisur nga përmbajtja e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe dispozitave të tjera që rregullojnë procesin e ristrukturimit, rradha e punës duhet të kalojë në fazat e mëposhtme:

- a) Fillimisht, bëhet një studim i veçantë (relacion), që tregon nevojën e institucionit për t'u përfshirë në ristrukturim;
- b) Hartohen përshkrimet e punës dhe përcaktohen kërkesat e përgjithshme e të veçanta për vendet e reja të punës që do të krijohen rishtas, apo që do të riorganizohen, me qëllim që të bëhet i mundur sistemimi i punonjësve të cilëve u preket vendi i punës;
- c) Bëhet parashikimi i pasojave financiare që sjell ky proces;

Po kështu, duhet të mbahet parasysh edhe detyrimi ligjor që ka institucioni që në rast ristrukturimi, nëpunësit të sistemohen brenda numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë, duke e konsideruar kalimin në listën e pritjes si mjetin e fundit që duhet të përdoret për largimin e nëpunësve civilë, me qëllim që të sigurohet **1)** memorja institucionale **2)** investimet e bëra nga institucioni tek nëpunësit civilë dhe **3)** të evitohet dëmi financiar në buxhetin e shtetit.

Më poshtë po analizojmë edhe **2 (dy)** struktura të tjera, në të cilat ka kaluar institucioni i Këshillit të Qarkut Durrës, për periudhën 2014-2015, të cilat janë edhe aktet që në fakt e materializojnë procesin e ristrukturimit në momentin e inspektimit dhe nëpërmjet krahasimit të tyre, do të nxjerrim në pah ndryshimet që kanë ndodhur si dhe problematikën e hasur në këtë rast.

- Struktura e miratuar me Vendimin nr. 41, datë 17.10.2014 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 6, datë 17.03.2014 të Këshillit të Qarkut "Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës"

Me vendimin e mësipër, struktura e Këshillit të Qarkut Durrës u rrit përsëri, duke u bërë nga **52** në **56** punonjës, prej të cilëve **43** pozicione, përfshiheshin në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil (pra, shihet se shtesa në organikë është bërë vetëm në numrin e nëpunësve civilë). Struktura e nëpunësve civile të institucionit kishte organizimin e mëposhtëm:

I.	Drejtoria e Koordinimit të Politikave të Qarkut	
	Drejtor	1
	- Sektori i Koordinimit, Hartimit dhe Zbatimit të Projekteve	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	4
	- Sektori i Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Mjedisit	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	2

II.	Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve	
	Drejtor	1
	- Sektori i Financës	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	2
	- Sektori i Shërbimeve Juridike	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	3
	- Sektori i Shërbimeve Rajonale	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	2
III.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	
	Drejtor	1
	- Sektori i Personelit dhe Arshivës	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	2
	- Sektori i IT-së dhe Statistikës	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	1
IV.	Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	
	Drejtor	1
	- Sektori i Urbanistikës,	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	3
	- Sektori i Turizmit dhe Kulturës	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	2
V.	Auditi i Brendshëm	
	specialist	1
VI.	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës,	
	Drejtor	1
	Sektori i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës,	
	përgjegjës sektori	1
	specialist	3
	Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës	
	Kryeinspektor	1
	Inspektorë	2

Totali

43 nëpunës civil

- Struktura aktuale pas ristrukturimit të fundit, me të cilën funksionon edhe në momentin e inspektimit, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës”

Në këtë rast, përbërja e administratës së Këshillit të Qarkut Durrës u reduktua përsëri duke mbetur vetëm **33** pozicione pune, prej të cilëve **23** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil dhe ka ndryshime të strukturës së pozicioneve të punës.

Struktura e nëpunësve civile të institucionit kishte organizimin e mëposhtëm:

I.	Drejtor	1
	Sektori i Hartimit, Koordinimit, Zbatimit të Projekteve dhe Politikave Sociale	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	4
	Sektori i Projekteve të Turizmit, Kulturës dhe Mjedisit	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	3
	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse	
	përgjegjës sektori	1
	specialistë	3
	Sektori i Urbanistikës dhe Shërbimeve Rajonale	
	përgjegjës sektori	1
	specialist	1
II.	Auditimi i Brendshëm	
	specialistë	1
III.	Protokoll – Arkiv	
	specialistë	1
IV.	Drejtor	1
	Sektori i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës,	
	përgjegjës sektori	1
	specialist	3

Totali

23 nëpunës civil

Mbas strukturës së fundit, të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës” në këtë institucion janë **23 pozicione pune**, pjesë e shërbimit civil sipas klasifikimit të mëposhtëm:

- **2** pozicione “Drejtor” (nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues);
- **5** pozicione “Përgjegjës sektori” (nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues);
- **16** pozicione “Specialist” (nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv).

Më poshtë po e pasqyrojmë në mënyrë tabelare këtë fakt, për të krijuar një përshtypje të qartë, se si është zhvilluar procesi, në vijimësi, në periudhën që përfshin vitet 2013 - 2015.

Tabelë: “Transformimi i strukturës së institucionit në periudhën 2013 – 2015”

1	2	3	4	5	6
Viti	Pozicione pune gjithsejt	Pozicione pune ne shërbimin civil	Drejtor drejtorie	Përgjegjës sektori/kryeinspektor	Specialist /inspektor
Viti 2013	63	48	5	10	33
Viti 2014 (Mars)	52	39	5	11	23
Viti 2014 (Tetor)	56	43	4	11	28
Viti 2015	33	23	2	5	16

Konkluzion:

Nga krahasimi i strukturave arrihet në konkluzionin se institucioni, Këshilli i Qarkut Durrës ka kaluar disa herë në proces ristrukturimi (*konstatohet plotësimi i dy kërkesave ligjore për të pasur një proces ristrukturimi: shkurtimi i numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe ndryshimi i strukturës organizative*), dhe aktualisht numri përgjithshëm i punonjësve është ulur nga **56** në **33** punonjës në përgjithësi dhe nga **43** nëpunës civil që ishin, mbetën vetëm **23**.

Në këtë kuptim **23** nëpunësit civilë të riemëruar pas procesit të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Durrës, do të realizojnë detyrat që më parë i kryenin **43** nëpunësit civilë e për rrjedhojë përzgjedhja e tyre duhej bërë mbi bazën e kërkesave për një nivel më të lartë profesional, me aftësi të mira organizative dhe menaxhuese, si dhe përvojën e duhur për zgjidhjen e problemeve, kritere këto, që janë mbajtur parasysht nga komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse, në marrjen e vendimeve përfundimtare të emërimit në pozicionet e mbetura pas procesit të ristrukturimit.

II/2/a. Situata në lidhje me punonjësit që janë sistemuar në këtë institucion, pas ristrukturimit, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil (në mënyrë më të hollësishme, janë të pasqyruara në Aneksin 3-historiku)

Procesi i ristrukturimit fillon të materializohet me miratimin e strukturës së re të institucionit dhe në përmbajtje përbëhet nga të gjitha aktet administrative që realizon njësia përgjegjëse gjatë implementimit të tij, ndër të cilat aktet e krijimit dhe të funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit; aktet e lirimit të nëpunësve që u është deklaruar i tepërt pozicioni i punës; aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit, etj.

Njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Durrës, bazuar në Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës”; Vendimin nr. 7, datë 11.02.2015 të Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore “Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit”; nenin 50 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; Vendimin nr.171, dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë,

pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, Udhëzimit nr.3, datë 14.04.2014 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit” të Departamentit të Administratës Publike, ka vijuar me procesin e ristrukturimit duke nxjerrë akete e transferimit për nëpunësit të cilët vazhdojnë të jene aktualisht në punë dhe lirim e nëpunësve nga shërbimi civil, pozicionet e punës të të cilëve janë suprimuar apo riorganizuar.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë të detajuar procesin e ristrukturimit, në lidhje me punonjësit që janë përfshirë në këtë proces dhe ende vijojnë të kryejnë funksionet e tyre në këtë institucion.

1. ***** – është transferuar pas ristrukturimit, në pozicionin “Drejtor” (nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II-b), me vendimin nr. 38, (nr. 342 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse “Për transferimin e nëpunësit ***** si rezultat i ristrukturimit të institucionit”.

Kjo punonjëse ka filluar marrëdhëniet e punës me urdhrin e brendshëm të drejtuesit të institucionit nr.144 (nr.1667 prot.) datë 09.12.2013 “Për emërimin në postin e Drejtorit të Burimeve Njerëzore të *****” në pozicionin e Drejtorit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Durrës. Marrëdhëniet financiare, sipas kontratës me nr. 1667/1 prot., datë 09.12.2013 dhe librezës së punës, kanë filluar në datën 16.12.2013. Më pas janë kryer procedurat konkurimit, duke respektuar rregullatë pranimit në shërbimin civil, konform ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe akteve nënligjore. Me vendimin nr. 4, datë 11.02.2014 “Për përzgjedhjen e kandidatit fitues pas konkurrimit për një vend të lirë pune” është përzgjedhur nga titullari dhe me urdhrin nr. 56, datë 03.04.2014 është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin Drejtores e Burimeve Njerëzore.

Nisur nga kjo, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit si nëpunëse civile në periudhë prove, me aktin administrativ nr. 812 prot., datë 26.05.2014, në pozicionin Drejtor i Burimeve Njerëzore.

Duke e krahasuar pozicionimin e saj pas ristrukturimit, rezulton se kjo nëpunëse mban të njëjtin pozicion pune, që ka patur para ristrukturimit.

2. ***** - është transferuar pas ristrukturimit, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorit të Hartimit, Kordinimit, Zbatimit të Projekteve dhe Polikave Sociale” (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III-a/1), me vendimin nr. 63, (nr. 367 prot.) datë 12.02.2015 të njesisë përgjegjëse “Për transferimin e nëpunësit ***** si rezultat i ristrukturimit të institucionit”.

Ky punonjës ka filluar marrëdhëniet e punës në Këshillin e Qarkut Durrës, me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 16, datë 01.02.2010, për emërimin me kontratë provizore tre mujore, në pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Projekteve në Drejtorinë e Politikave. Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës, kanë filluar në datën 01.02.2010.

Më pas janë kryer procedurat e konkurimit, konform ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil” dhe akteve nënligjore, me urdhërin e titullarit nr. 37, datë 20.06.2012 “Për emërim në detyrë” është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Projekteve në Drejtorinë e Politikave dhe pasi ka

kryer edhe periudhën e provës, është konfirmuar me vendimin nr. 1, datë 23.01.2013 në pozicionin *Përgjegjës në Sektorin e Kordinimit, Hartimit, Zbatimit dhe Monitorimit të Projekteve në Drejtorinë e Kordinimit të Politikave*.

Në këto kushte, me të drejtë, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si nëpunës civil, me aktin administrativ nr. 789 prot., datë 23.05.2014, në pozicionin *Përgjegjës në Sektorin e Kordinimit, Hartimit, Zbatimit dhe Monitorimit të Projekteve në Drejtorinë e Kordinimit të Politikave të Këshillin e Qarkut Durrës*.

Duke e krahasuar pozicionimin e tij pas ristrukturimit, rezulton se ky punonjës mban të njëjtin pozicion pune, që ka patur para ristrukturimit.

3. ***** - është e emëruar në Këshillin e Qarkut Durrës në pozicionin *Specialiste për Asistencë Juridike në Implementimin e Projekteve në Sektorin e Hartimit, Kordinimit, Zbatimit të Projekteve dhe Politikave Sociale (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b)* me aktin e emërimit në shërbimin civil nr. 251, datë 03.02.2015, pas kryerjes së procedurave të rekrutimit në bazë të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.
Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës kanë filluar në datë 03.02.2015.

Kjo marrëdhënie punë, ka filluar rregullisht, pas kryerjes së procedurave të rregullta të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar. Vazhdon periudha e provës.

4. ***** - është transferuar pas ristrukturimit, në pozicionin "*Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Projekteve të Turizmit, Kulturës dhe Mjedisit*" (*nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III-a/1*), me vendimin nr. 48, (nr. 352 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse "*Për transferimin e nëpunësit ***** si rezultat i ristrukturimit të institucionit*".

Kjo punonjëse ka filluar marrëdhëniet e punës me urdhrin e brendshëm nr. 150, (nr. 1721 prot.) datë 16.12.2013 "*Për emërimin e ******", fillimisht me kontratë 3 (tre) mujore, nr. 1721/1, datë 16.12.2013, në pozicionin *Përgjegjëse e Sektorit të Personelit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Durrës*. Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës kanë filluar në datën 16.12.2013.

Është emëruar si nëpunëse civil në periudhë prove, pas kryerjes së procedurave të konkurimit, me urdhrin nr. 50, datë 31.03.2014. Me vendimin nr. 9, datë 03.04.2014 "*Për transferimin e nëpunësit ***** si rezultat i ristrukturimit të institucionit*" sipas strukturës së miratuar me vendimin nr. 6, datë 17.03.2014 "*Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës*", ripozicionohet në pozicionin "*Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Turizmit dhe Kulturës pranë Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit*".

Në kushte të tilla, me të drejtë njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 786, datë 22.05.2014, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin "*Përgjegjës Sektori në Sektorin e Turizmit dhe Kulturës pranë Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit*".

Edhe kjo punonjëse rezulton se para ristrukturimit ka qenë në të njëjtin pozicion pune, ku është emëruar rishtaz pas ristrukturimit.

5. ***** - është transferuar pas ristrukturimit, në pozicionin *Specialist për Menaxhimin dhe Zhvillimin e Mjedisit në Sektorin e Projekteve, Turizmit, Kulturës dhe Mjedisit* (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b, me vendimin nr. 51, (nr. 355 prot.,) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse “Për transferimin e nëpunësit ***** si rezultat i ristrukturimit të institucionit”.

Kjo punonjëse ka filluar marrëdhëniet e punës në Këshillin e Qarkut Durrës, me urdhrin e brendshëm nr. 147, (nr. 1668 prot.,) datë 09.12.2013 për emërimin e saj me kontratë në pozicionin *Specialist i Menaxhimit dhe Zhvillimit të Mjedisit në Sektorin e Turizmit dhe Kulturës në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit*. Marrëdhëniet financiare në këtë pozicion, sipas librezës së punës kanë filluar pikërisht në datë 09.12.2013 (më parë kjo nëpunëse mbulonte pozicionin jashtë shërbimit, civil sikëshilltare e kryetarit).

Megjithëse me fillimin e efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” kësaj punonjëseje i ka lindur e drejta e përfitimit të statusit të punësimit, në atë pozicion që mbulonte, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar. Aktualisht, nuk ka akt deklarimi të statusit të punësimit.

Me urdhrin e titullarit nr. 55, datë 03.04.2014 “Për emërimin e *****” kalon në pozicionin *Përgjegjës në Sektorin e Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Mjedisit pranë Drejtorisë së Zhvillimit të Politikave pranë Këshillit të Qarkut Durrës (pa kryer procedurë konkurimi për ngritje në detyrë).*

Duke qenë se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, (data 26.02.2014) kësaj punonjëseje i ka lindur e drejta e trajtimit si nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Turizmit, Kulturës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në Drejtorinë e Koordinimit të Politikave të Qarkut*”, ligji nuk lejon kalimin në një detyrë më të lartë pa respektuar procedurat e nevojshme. Në këto kushte, akti i emërimit nr. 55, datë 03.04.2014 “Për emërimin e *****” në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Mjedisit pranë Drejtorisë së Zhvillimit të Politikave pranë Këshillit të Qarkut Durrës*” është aktabsolutisht i pavlefshëm dhe duhet të revokohet nga ana e organit që e ka nxjerrë.

Për sa më sipër, së pari njësia përgjegjëse duhet të përfundojë procesin e verifikimit të statusit të punësimit sipas kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) duke e deklaruar si nëpunës civil në pozicionin *Specialist i Menaxhimit dhe Zhvillimit të Mjedisit në Sektorin e Turizmit dhe Kulturës në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit*. Në përfundim të deklarojë statusin e punësimit, sipas kësaj dispozite. Së dyti të vazhdojë me procesin e sistemimit në kuadër të ristrukturimit.

6. ***** – aktualisht, është emëruar pas ristrukturimit, në pozicionin *Përgjegjëse në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse* (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III-a/1), me vendimin nr. 37, (nr. 341 prot.,) datë 12.02.2015 të njesisë përgjegjëse “Për transferimin e nëpunësit ***** si rezultat i ristrukturimit të institucionit”.

Kjo punonjëse ka filluar marrëdhëniet e punës me urdhrin e brendshëm nr. 157, (nr. 1755 prot.,) datë 20.12.2013, nr. 1775/1, datë 20.12.2013, për emërimin me kontratë 3 (tre) mujore, në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Juridike në Drejtorinë*

Ekonomike dhe të Shërbimeve në Këshillin e Qarkut Durrës". Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës, kanë filluar në datën 23.12.2013.

Pas kryerjes së procedurave të konkurimit konform ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil" dhe akteve nënligjore, me urdhrin nr. 57, datë 03.04.2014 është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin *Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Juridike në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve*.

Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 806, datë 26.05.2014, sipas kërkesave të nenit 67 të tij, në pozicionin, *nëpunës civil në periudhë prove*, në pozicionin "Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Juridike në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve".

Pas ristrukturimit, kjo punonjëse mban të njëjtin pozicion dhe nivel që kishte para ristrukturimit.

7. ***** - është riemëruar pas ristrukturimit, në pozicionin "Specialiste e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Qarkut Durrës" (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b), me vendimin nr. 36, (nr. 340 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse "Për transferimin e nëpunësit ***** si rezultat i ristrukturimit të institucionit".

Kjo punonjëse i ka filluar marrëdhëniet e punës me urdhrin e brendshëm nr. 13, (nr. 70 prot.) datë 20.01.2014 për emërimin e saj me kontratë 3 (tre) mujore (kontrata nr. 70/1, datë 20.01.2014) në pozicionin Sekretare e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës. Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës kanë filluar në datën 20.01.2014.

Më pas me urdhrin nr. 40, datë 25.02.2014 emërohet po me kontratë 3 (tre) mujore (kontrata nr. 278, datë 25.02.2014) në pozicionin *Specialiste e Statistikave në Sektorin e Teknologjisë, Informacionit dhe Statistikave në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Durrës*.

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se ditën e fillimit të efekteve të ligjit, në datë 26.02.2014, ka qenë punonjëse efektive në pozicionin *Specialiste e Statistikave në Sektorin e Teknologjisë, Informacionit dhe Statistikave në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore* si rrjedhojë, ajo duhet të përfitojë nga mundësia që jep dispozita e nenit 67 për fitimin e statusit të nëpunësit civil.

Është detyrë e njesisë të burimeve njerëzore, të nxjerrin aktin e deklarimit të statusit të punësimit, në pozicionin *Specialiste e Statistikave në Sektorin e Teknologjisë, Informacionit dhe Statistikave në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Durrës*, nëpunëse civile në periudhë prove. Nga ana e kësaj të fundit duhet të merren masat që të plotësojë dhe kërkesat e ligjit për kryerjen e trajnimit të detyruar në Shkollën e Administratës Publike (ASP) dhe vetëm pas kësaj të shqyrtohet problem i konfirmimit si nëpunëse civile.

8. ***** - është transferuar pas ristrukturimit, në pozicionin "Specialist i Financës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse pranë Këshillit të Qarkut Durrës" (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b) me vendimin nr. 39, (nr. 343 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse "Për transferimin e nëpunësit ***** si rezultat i ristrukturimit të institucionit".

Marrëdhëniet e punës me Këshillin e Qarkut Durrës, kjo punonjëse i ka filluar me kontratë pune në datën 01.05.2001, në pozicionin *Specialiste në Seksionin e Financës*.

Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës kanë filluar në datën 01.05.2001. Më pas me urdhrin nr. 27, datë 31.07.2007 emërohet në pozicionin *Përgjegjëse e Sektorit të Financës* në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve në Këshillin e Qarkut Durrës.

Me vendimin nr. 3, datë 29.01.2008 "*Për përzgjedhjen e kandidatit fitues pas konkurrimit për një vend të lirë pune*" kjo punonjëse, me urdhrin e titullarit nr. 17, datë 29.01.2008 është përzgjedhur nga titullari dhe është emëruar në punë civile në periudhë prove, në pozicionin *Përgjegjëse e Sektorit të Financës* në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve në Këshillin e Qarkut Durrës. Pas plotësimit të periudhës së provës, me aktin administrativ nr. 6, datë 09.02.2009, është konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin "*Përgjegjëse e Sektorit të Financës në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve*".

Në kushte të tilla, me të drejtë njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin nr. 792 prot., datë 23.05.2014 për deklarinimin e statusit të punësimit, sipas kërkesave të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në pozicionin "*Përgjegjëse e sektorit të financës në drejtorinë ekonomike dhe shërbimeve*".

9. ***** – Ka filluar marrëdhënien e punës për herë të parë në Këshillin e Qarkut Durrës në pozicionin *Specialist për Prokurimet Publike* në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, me aktin e emërimit nr. 217, datë 30.01.2015 për emërimin si nëpunës civil në periudhë prove (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b), pas kryerjes së procedurës së rregullt të konkurimit.

Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës kanë filluar, gjithashtu, në datën 30.01.2015.

Kjo marrëdhënie punë, ka filluar rregullisht, pas kryerjes së procedurave të rregullta të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar. Vazhdon periudha e provës.

10. ***** – është transferuar pas ristrukturimit, në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës dhe Shërbimeve Rajonalenë Këshilline Qarkut Durrës*" (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III-a/1) me vendimin nr. 58, (nr. 362 prot.,) datë 12.02.2015 të njësisë përgjegjëse "*Për transferimin e nëpunësit ***** si rezultat i ristrukturimit të institucionit*".

Ky punonjës ka filluar për herë të parë marrëdhëniet e punës me Këshillin e Qarkut Durrës, në bazë të urdhrin të brendshëm nr. 1, (nr. 20 prot.,) datë 09.01.2014 për emërimin me kontratë 3 (tre) mujore (kontrata nr. 20/1, datë 09.01.2014) në pozicionin *Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Shërbimeve Rajonale* në Këshillin e Qarkut Durrës. Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës, kanë filluar në datën 10.01.2014.

Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në bazë të nenit 67 të tij, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin nr. 783, datë 22.05.2014 për deklarinimin e statusit të punësimit, si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin *Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Shërbimeve Rajonalenë Këshillin e Qarkut Durrës*.

Pas ristrukturimit të fundit, pavarësisht, se ky punonjës kishte përfunduar statusin e nëpunësit civil të nivelit të mesëm drejtues, për shkak të shkurtimit të vendit të punës pas implementimit të strukturës së fundit, ka pranuar një pozicion të një niveli më të ulët, dhe njësi përgjegjëse me të drejtë e ka konfirmuar atë në pozicionin që mban aktualisht

Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës dhe Shërbimeve Rajonale në Këshillin e Qarkut Durrës”.

11. ***** - është transferuar pas ristrukturimit, në pozicionin “*Specialist i Shërbimeve Rajonalenë Drejtorine e Planifikimit të Territorit dhe Shërbimeve Rajonale në Këshillin e Qarkut Durrës*” (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b) me vendimin nr. 52, (nr. 356 prot.) datë 12.02.2015 të njësisë përgjegjëse “*Për transferimin e nëpunësit ***** si rezultat i ristrukturimit të institucionit*”.

Marrëdhënia e punës së këtij punonjësi ka filluar me emërim të përkohshëm, me urdhrin e brendshëm nr. 37, datë 25.02.2014, me kontratë 3 (tre) mujore (kontrata nr. 290, datë 28.02.2014) në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Rajonale në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Shërbimeve Rajonale në Këshillin e Qarkut Durrës*.

Njësia përgjegjëse me të drejtë, ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr.795, datë 23.05.2014 duke e emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin e mësipërm.

Akti i deklaramit të statusit vlerësohet i dhënë në përputhje me ligjin pasi, marrëdhënia e punës së këtij nëpunësi është lidhur para fillimit të efekteve tëligjit nr. 152/2013 (data 26.02.2014).

12. ***** – është transferuar pas ristrukturimit në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Auditit të Brendshëm në Këshillin e Qarkut Durrës*” (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b), pozicioni pune, të cilin ka mbajtur që nga momenti i emërimit në përmjet procedurës së lëvizjes paralele, me urdhrin nr. 12/5, datë 29.01.2010 “Për emërm në detyrë”. Kjo punonjëse është e pajisur me çertifikatën “*Auditues i brendshëm në sektorin publik*”.

Kjo punonjëse ka filluar marrëdhëniet e punës në Këshillin e Qarkut Durrës, me kontratë pune, sipas librezës së punës, në datë 16.02.2001 në pozicionin *Specialist në Seksionin e Shërbimeve Rajonale*. Është konfirmuar si nëpunëse civile me vendimin nr. 237, datë 06.03.2002. Më pas me urdhrin nr. 27/1, datë 31.05.2007 kalon nga “*specialiste në Seksionin e Shërbimeve Rajonale*” në pozicionin “*specialiste në Sektorin e Shërbimeve në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve*”. Në zbatim të nenit 15 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i Nëpunësit Civil*”, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, (Verifikuar me aktet e publikimit në datën 25.11.2009). Më pas, me urdhrin nr. 59, datë 28.09.2009 ka kaluar *Specialiste e Auditit*. Konfirmohet në të njëjtin pozicion me urdhrin nr. 7, datë 07.01.2011, aktualisht, është deklaruar nëpunëse civile me aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 787 prot., datë 22.05.2014, status të cilin vazhdon ta gëzojë.

13. ***** - Ka filluar marrëdhëniet e punës me aktin e emërimit në shërbimin civil nr. 91, datë 15.01.2015 për emërimin si nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin *Specialist për Protokoll-arkiv* në Sektorin e Personelit dhe Arkivës në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Durrës (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b). Marrëdhëniet financiare kanë filluar në datën 15.01.2015. Kjo marrëdhënie punë, ka filluar rregullisht, pas kryerjes së procedurave të rregullta të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Vazhdon periudha e provës.

14. ***** - është transferuar pas ristrukturimit në pozicionin Drejtor i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, (nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria III-b), pozicioni pune, të cilin ka mbajtur që nga momenti i emërimit me urdhrin e titullarit nr.90, datë 18.06.2013, nëpunës civil në periudhë prove, pas kryerjes së procedurës së konkurimit, në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”.
- Ky punonjës ka filluar marrëdhëniet e punës në Këshillin e Qarkut Durrës, që në datën 16.09.1996, në pozicionin *Specialist* në Seksionin Ekonomik të Shërbimeve.
- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i Nëpunësit Civil*” Konfirmohet si nëpunës civil ekzistues, në zbatim të nenit 27, Kreu X, “Dispozita Kalimtare”, me aktin nr. 237, datë 06.03.2002, në pozicionin *Specialist në Seksionin e Shërbimeve Rajonale në Këshillin e Qarkut Durrës*.
- Më pas me urdhrin nr. 68, nr. 1708 prot., datë 18.10.2010 emërohet fillimisht, me kontratë 3 (tre) mujore *Drejtor i AMT* në Këshillin e Qarkut Durrës dhe pas përfundimit të procedurës së konkurimit është emëruar përfundimisht, me vendimin nr. 17, datë 31.05.2013 “*Për përzgjedhjen e kandidatit fitues pas konkurrimit për një vend të lirë pune*” në pozicionin Drejtor i Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
- Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” është plotësuar dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit me nr. 778 prot., datë 22.05.2014 si nëpunës civil në periudhë prove.
- Pas kryerjes së periudhës së provës dhe plotësimit të detyrimeve ligjore që përmban ky proces, si rezultati i trajnimit në ASPA (24 pikë nga 26), vlerësimi i rezultateve individuale në punë me nivelin 2 (mirë), nëpunësi në fjalë është konfirmuar si nëpunës civil me vendimin nr. 5, (nr. 124 prot.) datë 20.01.2015 të drejtuesit të institucionit.
15. ***** – është e emëruar në Këshillin e Qarkut Durrës, me aktin e emërimit nr. 266 prot., datë 05.02.2015, në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria IV-a), nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, sipas nenit 26 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Kjo punonjëse ka filluar për herë të parë marrëdhënien e punës në Këshillin e Qarkut Durrës, me urdhrin e brendshëm nr. 69, datë 02.12.2009, (me kontratë pune 3(tre) mujore, me nr. 2026 prot., datë 02.12.2009) në pozicionin *Specialist* në Seksionin e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Durrës. Marrëdhëniet financiare, sipas librezes së punës, kanë filluar në datën 02.12.2009. Më pas me urdhrin nr. 37/4, datë 20.06.2011 është emëruar përfundimisht, pas kryerjes së procedurës së konkurimit, nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin *Specialiste* në Sektorin AMT në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
- Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” e ka gjetur në pozicionin *Specialiste* në Seksionin e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës dhe për këtë shkak për këtë pozicion është nxjerrë dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 779 prot., datë 22.05.2014. Aktualisht, pas kryerjes së procedurës së konkurimit, ajo gëzon statusin e nëpunëses civile të nivelit të ulët drejtues në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
16. ***** – është e emëruar për herë të parë në Këshillin e Qarkut Durrës, në pozicionin *Specialist i Mirëmbajtjes dhe Ruajtjes së Dokumentacionit Kadastral në Sektorin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Drejtorinë e Administrimit dhe*

Mbrojtjes së Tokës (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-b), me aktin e emërimit në shërbimin civil nr. 149, datë 23.01.2015, pas kryerjes së procedurës së konkurimit në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës, kanë filluar në datën 23.01.2015.

Ky punonjës është i vjetër në Këshillin e Qarkut Durrës, emëruar me kontratë me urdhrin nr. 60, datë 19.09.2011, por është liruar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 73 datë 18.04.2014 “Për lirim nga detyra të *****”, si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore të miratuara me vendimin nr. 06, datë 17.03.2014 “Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”.

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur këtë punonjës në Këshillin e Qarkut Durrës e për rrjedhojë ka përfutur statusin e nëpunësit civil, pavarësisht si kish filluar marrëdhënia e punës. Në këto kushte njësia përgjegjëse duhet të kishte përfunduar procesin e deklarimit të statusit të punësimit, gjë që do ta bënte të panevojshme kryerjen e procedurës së konkurimit. Megjithatë, fakti që nëpunësi në fjalë, i është nënshtruar përsëri konkurimit dhe është shpallur fitues, nuk e cënon rregullshmërinë e marrëdhënies aktuale të punës (shih shkresat nr. 1254, datë 10.09.2014 për ngritjen e KPP, urdhërin nr. 127, datë 13.11.2014 dhe shpalljen e fituesit në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, me shkresën nr. 1688, datë 25.11.2014).

II/2/b. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohëshme emërimi, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të cilët janë sistemuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, pas ristrukturimit.

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, konstatohet se në këtë institucion, në kundërshtim me ligjin, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme në 6 raste dhe konkretisht, bëhet fjalë për pozicionet të cilët po i trajtojmë më hollësisht në vijim:

1. ***** – është emëruar si punonjëse e Këshillit të Qarkut Durrës, me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 81, datë 28.04.2014 për emërimin me kontratë të përkohshme, në pozicionin *Specialist i koordinimit dhe hartimit të projekteve në Sektorin e Hartimit, Kordinimit, Zbatimit të Projekteve dhe Politikave Sociale, (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b)*. Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës kanë filluar në datën 28.04.2014.

Konsiderojmë se ndodhemi para faktit që momentii fillimit të efekteve juridike të ligjit (data 26.02.2014), nuk e ka gjetur këtë punonjëse në marrëdhënie pune, veç kësaj me ndryshimet strukturore të miratuara me Vendimin nr. 06 datë 17.03.2014 “Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”, në Këshillin e Qarkut Durrës ka reduktim të numrit të nëpunësve civil, dhe konkretisht: Drejtoria e Koordinimit të Politikave të Qarkut nga 13 punonjës reduktohet në 7 punonjës. Nga sa më sipër, nuk justifikohet marrja në punë me kontratë të përkohshme në një kohë që u larguan nga shërbimi civil 7 punonjës ekzistues të kësaj drejtorie.

Ky fakt nuk është marrë parasysh nga institucioni, por është vazhduar me procedurat e rekrutimit sipas ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në përfundim të procesit të konkurimit, kjo punonjëse, me aktin nr.1738 prot., datë 03.12.2014 është emëruar si nëpunës civil në periudhë prove, në kategorinë ekzekutive.

Nga verifikimet rezultoi që procedura është zhvilluar duke respektuar kërkesat e udhëzimit nr. 4, datë 13.08.2014, të Departamentit të Administratës Publike, por nga ana e njësisë përgjegjëse nuk janë respektuar kriteret e parashikuar në Lidhjen 2, kategoria III, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimit e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, dhe VKM nr.1619, datë 02.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, ndryshuar me VKM nr. 693, datë 18.08.2010, lidhja nr.3, lidhja nr. 4 dhe lidhja nr. 7. Pozicioni specialist i Koordinimit dhe Hartimit të Projekteve klasifikohet në kategorinë e pagës III-b, duke ju referuar lidhjes nr.7 të vendimit të mësipërm, arsimimi për këtë kategori nëpunës është Diplome e integruar e nivelit të dytë (master shkencor)/diploma e integruar e nivelit të parë (master profesional).

Me strukturën e re të miratuar me vendimin e Këshillit të Qarkut Tiranë, nr. 2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës” kjo nëpunëse ka kaluar në pozicionin *Specialist i koordinimit dhe hartimit të projekteve në Sektorin e Hartimit, Kordinimit, Zbatimit të Projekteve dhe Politikave Sociale.*

***** ka mbaruar Universitetin Tiranës, Fakulteti Histori Filologji, Dega Gazetari (zotëron vetëm **diplomën Bachelor**) në datë 11.07.2011, vazhdon studimet për master. Pra, nisur nga sa më sipër, kjo punonjëse nuk përmbush kërkesat e ligjit, për të mbajtur pozicionin në të cilin punon aktualisht.

2. ***** – është emëruar si punonjëse e Këshillit të Qarkut Durrës, me urdhërin nr.67, datë 14.04.2014 për emërimin me kontratë të përkohshme, në pozicionin *Specialist i Zbatimit të Projekteve në Sektorin e Hartimit, Kordinimit, Zbatimit të Projekteve dhe Politikave Sociale (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b).* Pozicion të cilin e mban edhe me strukturën e re të miratuar me vendimin e Këshillit të Qarkut Tiranë, nr. 2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës”. Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punëskanë filluar në datën 17.04.2014, pra pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Struktura ekzistuese në këtë kohë, e miratuar me vendimin nr. 06 datë 17.03.2014 “Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”, solli reduktim të numrit të nëpunësve civil, (konkretisht, Drejtoria e Koordinimit të Politikave të Qarkut, nga 13 punonjës që kishte, është pakësuar në 7 punonjës), gjë e cila nuk e justifikon marrjen në punë me kontratë të përkohshme të kësaj punonjëseje, në një kohë që për shkak të shkurtimit të vendeve të punës, ish vendosur largimi nga shërbimi civil i 6 nëpunësve civil ekzistues. Pra, në kundërshtim me nevojat dhe kërkesat ligjore, nga ana e institucionit është vazhduar me procedurat e rekrutimit sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pas përfundimit të tyre, me aktin e emërimit në shërbimin civil menr.1743 prot., datë 05.12.2014, kjo punonjëse është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në kategorinë ekzekutive në pozicionin *Specialist i Zbatimit të Projekteve në Sektorin e Hartimit, Kordinimit, Zbatimit të Projekteve dhe Politikave Sociale.* Nga verifikimet rezultoi që procedura është zhvilluar në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 4, datë 13.08.2014 të Departamentit të Administratës Publike, por nga ana e njësisë përgjegjëse nuk janë respektuar kriteret e parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimit e pozicioneve të

punës në institucionet e administratës shtëtorore dhe institucionet e pavarura”, dhe Vendimi KMnr.1619, datë 02.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, ndryshuar me VKM nr.693, datë 18.08.2010, lidhja nr.3, lidhja nr. 4 dhe lidhja nr. 7. Pozicioni specialist i Koordinimit dhe Hartimit të Projekteve është pozicion me kategoritë pagës III-b, gjë e cila në bazë të lidhjes nr. 7 të vendimit të mësipërm, kërkon nivel arsimor “Diplomëtë integruar të nivelit të dytë (master shkencor) ose diplomëtë integruar të nivelit të parë (master profesional)”.

****** ka mbaruar studimet universitare në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti Ekonomik, Dega Financë-Bankë (zotëron vetëm **diplomën Bachelor**) në datë 16.06.2012, vazhdon studimet për master. Fakti që ajo vazhdon studimet nuk e favorizon atë, pasi kjo mundësi njihet vetëm për punonjës me këtë nivel arsimor dhe me arsim në vazhdim vetëm për institucionet që futen për herë të parë në shërbimin civil. Në raport me pozicionin e punës që mban aktualisht, kjo nëpunëse nuk plotëson kërkesat ligjore.*

3. ****** – Ka filluar marrëdhëniet e punës në Këshillin e Qarkut Durrës me aktin e emërimit nr. 53, datë 03.04.2014 “Për emërimin me kontratë tre mujore të ***** në pozicionin *Specialist e Zhvillimit të Mjedisit në Sektorin e Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Mjedisit* në Drejtorinë e Koordinimit të Politikave (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b*)”.*

Marrëdhëniet financiare kanë filluar në datë 03.04.2014, pra është marrë në punë pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Edhe për këtë rast duhet thënë se struktura ekzistuese në kohën e lidhjes së kësaj marrëdhënie pune, e miratuar me vendimin nr. 06, datë 17.03.2014 “Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”, solli reduktim të numrit të nëpunësve civil, (konkretisht, Drejtoria e Koordinimit të Politikave të Qarkut, nga 13 punonjës që kishte, është pakësuar në 7 punonjës), gjë e cila nuk e justifikon faktin e marrjes në punë me kontratë të përkohshme të kësaj punonjëseje, në një kohë që ishte vendosur largimi nga shërbimi civil i 6 nëpunësve ekzistues.

Ky fakt nuk është vlerësuar drejt nga institucioni, por është vazhduar me procedurat e rekrutimit sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe pas përfundimit të tyre, kjo punonjëse me aktin nr. 1740, datë 03.12.2014 është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove.

*Më pas, me implementimin e strukturës së miratuar me vendimin nr. 2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës” me aktin nr. 49, (nr. 353 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse “Për transferimin e nëpunësit ***** si rezultat i ristrukturimit të institucionit” kalon në pozicionin specialist për koordinimin e politikave sociale në Sektorin e Koordinimit, Hartimit, Zbatimit të Projekteve dhe Politikave sociale në Këshillin e Qarkut Durrës, pozicion të cilin e mban edhe aktualisht.*

Nga verifikimi i gjithë akteve që përbëjnë këtë marrëdhënie punësimi, rezulton se pavarësisht që edhe në këtë rast, formalisht, janë respektuar kërkesat dhe rregullat për zhvillimin e procedurës së konkurimit, ashtu siç përcaktohen në udhëzimin nr. 4, datë 13.08.2014 të Departamentit të Administratës Publike, nuk është mbajtur parasysh kërkesa e nivelit arsimor për këtë pozicion pune, parashikuar prej VKM nr. 142, datë

12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimit e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, dhe VKM nr.1619, datë 02.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, ndryshuar me VKM nr. 693, datë 18.8.2010, lidhja nr. 3, lidhja nr. 4 dhe lidhja nr. 7.

Pozicioni specialist i Koordinimit dhe Hartimit të Projekteve i takon kategorisë së pagës III-b, gjë që në bazë të lidhjes nr. 7 të vendimit të mësipërm, niveli arsimor për këtë kategori nëpunësie është “Diplomë e integruar e nivelit të dytë (master shkencor) ose diploma e integruar e nivelit të parë (master profesional)”.

***** në momentin e fillimit të marrëdhënies së punës kishte mbaruar studimet universitare vetëm për ciklin e parë “Bachelor” në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, në datë 30.10.2009 dhe vazhonte ciklin e dytë të studimeve universitare, (vërtetimin nr. 91, datë 19.03.2014 i universitetit “Aleksander Moisiu” Durrës që është student e vitit të parë në ciklin e dytë të studimeve master shkencor). Fakti që ajo vazhdon studimet nuk e favorizon atë, pasi kjo mundësi njihet për punonjës me këtë nivel arsimor dhe me arsim në vazhdim për institucionet që futen për herë të parë në shërbimin civil. Në raport me pozicionin e punës që mban aktualisht, kjo nëpunëse nuk plotëson kërkesat ligjore.

4. ***** – Ka filluar marrëdhëniet e punës në Këshillin e Qarkut Durrës me aktin nr. 87, datë 02.05.2014 për emërimin e ***** me kontratë 3 (tre) mujore, në pozicionin *Specialiste e Turizmit* në Sektorin e Turizmit dhe Kulturës në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b*). Marrëdhëniet financiare kanë filluar në datë 02.05.2014, pra edhe në këtë rast pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Edhe për këtë rast duhet thënë se struktura ekzistuese në kohën e lidhjes së kësaj marrëdhënie pune, e miratuar me vendimin nr. 06, datë 17.03.2014 “Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”, solli reduktim të numrit të nëpunësve civil, (konkretisht, Drejtoria e Koordinimit të Politikave të Qarkut, nga 13 punonjës që kishte, është pakësuar në 7 punonjës), gjë e cila nuk e justifikon faktin e marrjes në punë me kontratë të përkohshme të kësaj punonjëseje, në një kohë që ishte vendosur largimi nga shërbimi civil i 6 nëpunësve ekzistues.

Ky fakt nuk është marrë parasysh nga institucioni por është vazhduar me procedurat e rekrutimit sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe ***** është futur në testim dhe është fituese e konkurimit për pozicionin e mësipërm. Me aktin nr. 1689, datë 26.11.2014 është bërë emërimi saj *nëpunës civil në periudhë prove*, në pozicionin *specialist turizmi në sektorin e turizmit dhe kulturës në drejtorinë e zhvillimit urban dhe turizmit*. ***** ka mbaruar Universitetin e Tiranës, Fakultetin Ekonomik, Dega Mercologji.

Me strukturën e re të miratuar me vendimin e Këshillit të Qarkut Tiranë, nr. 2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës” kjo nëpunëse është ripozicionuar në pozicionin *specialist e turizmit në sektorin e turizmit, kulturës dhe mjedisit*, pranë Këshillit të Qarkut Durrës.

5. ***** – Ka filluar marrëdhëniet e punës në Këshillin e Qarkut Durrës me aktin nr. 80, datë 24.04.2014 “Për emërimin e ***** me kontratë 3 (tre) mujore në

pozicionin Specialist e Kulturës në Sektorin e Turizmit dhe Kulturës në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b)”.

Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës kanë filluar në datën 24.04.2014, pra edhe në këtë rast, pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Edhe për këtë rast duhet thënë se struktura ekzistuese në kohën e lidhjes së kësaj marrëdhënie pune, e miratuar me vendimin nr. 06, datë 17.03.2014 “Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”, solli reduktim të numrit të nëpunësve civil, gjë e cila nuk e justifikon faktin e marrjes në punë me kontratë të përkohshme të kësaj punonjëseje, në një kohë që ish vendosur largimi nga shërbimi civil i shumë prej nëpunësve ekzistues.

Pavarësisht kësaj, nga ana e njësisë së burimeve njerëzore është vijuar me kryerjen e procedurës së rekrutimit sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe me e aktin e emërimit në shërbimin civil nr. 1703, datë 27.11.2014 emërohet nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin specialist kulture në sektorin e turizmit dhe kulturës në drejtorinë e zhvillimit urban dhe turizmit.

Nga verifikimet rezulton që procedura e konkurimit është zhvilluar në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 4, date 13.08.2014 të Departamentit të Administratës Publike, por nga ana e njësisë përgjegjëse nuk janë respektuar kriteret e parashikuar në VKM nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimit e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, dhe VKM nr.1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, ndryshuar me VKM nr. 693, datë 18.08.2010, lidhja nr. 3, lidhja nr. 4 dhe lidhja nr. 7.

Ripozicionohet me strukturën e re të miratuar me vendimin e Këshillit të Qarkut Tiranë, nr. 2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës” në pozicionin *specialist ikulturës në sektorin e turizmit, kulturës dhe mjedisit* pranë Këshillit të Qarkut Durrës. Ky pozicion është në kategorinë e pagës III-b, duke ju referuar lidhjes nr. 7 të vendimit të mësipërm, arsimimi për këtë kategori nëpunësish është diplomë e integruar e nivelit të dytë (master shkencor)/diploma e integruar e nivelit të parë (master profesional).

***** ka mbaruar studimet e ciklit të parë niveli “Bachelor”, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën në datë 30.10.2013 dhe vazhdon studimet në ciklin e dytë të studimeve në nivelin Master (vërtetimi nr. 1014, datë 05.11.2013 I Universitetit “Aleksander Moisiu” që është rregjistruar si studente në ciklin e dytë të studimeve master shkencor 2013 – 2014). Fakti që ajo vazhdon studimet nuk e favorizon atë, pasi kjo mundësi njihet për punonjës me këtë nivel arsimor dhe me arsim në vazhdim për institucionet që futen për herë të parë në shërbimin civil. Në raport me pozicionin e punës që mban aktualisht, kjo nëpunëse nuk plotëson kërkesat ligjore.

6. ***** – Ka filluar marrëdhëniet e punës në Këshillin e Qarkut Durrës me aktine emërimit nr. 74, datë 21.04.2014, në pozicionin *Specialisti Koordinimit të Dokumentave*

Kadastralenë Sektorin e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-b).

Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës, kanë filluar në datë 21.04.2014.

Edhe për këtë punonjës fillimi i efekteve juridike të ligjit nuk e ka gjetur në marrëdhënie pune. Struktura e re e miratuar me vendimin nr. 06 datë 17.03.2014 “Për disa ndryshime në strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës nuk solli ndryshim në numrin e punonjësve, por vendi i lirë ku u sistemua punonjësi në fjalë ishte krijuar si rezultat i lirit nga shërbimi civil i disa punonjësve ekzistues.

Është vazhduar me procedurat e rekrutimit sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 1704 prot., datë 27.11.2014 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin Specialisti Koordinimit të Dokumentave Kadastralenë Sektorin e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës.

Pas miratimit dhe zbatimit të strukturës me vendimin e Këshillit të Qarkut Tiranë, nr. 2, datë 30.01.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës” ky punonjës është lënë në të njëjtën detyrë, *Specialisti Koordinimit të Dokumentave Kadastrale* në Sektorin e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës, në Këshillin e Qarkut Durrës, detyrë të cilën vazhdon ta kryejë edhe aktualisht.

Konkluzion:

Për punonjëset, *****, *****, ***** dhe *****, pavarësisht se, formalisht, është respektuar procedura e pranimit në shërbimin civil sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, marrëdhënia e punësimit të tyre nuk është e rregullt, për arsyt e mëposhtme:

1. Në momentin e kryerjes së konkurimit, gjë e cila shënon dhe fillimin e marrëdhënies në shërbimin civil, këto punonjëse nuk kanë plotësuar kriterin arsimor që kërkon niveli i nëpunësisë dhe pagesës që kërkojnë pozicionet e punës. Pavarësisht se në aktet e shpalljes së pozicioneve të lira për konkurim, ishte shënuar si kërkesë niveli arsimor “bachelor”, në bazë të VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, lidhja 2, dhe VKM nr.1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, ndryshuar me VKM nr. 693, datë 18.08.2010, lidhja nr. 3, nr. 4 dhe nr. 7, pozicionet e punës së kësaj kategorie ku pagesa është e nivelit *III-a*, kërkohet arsimi i lartë, i përfunduar, me diplomë të integruar të nivelit të dytë (master shkencor) / diplomë të integruar të nivelit të parë (master profesional).

Fakti që ato vazhdojnë studimet nuk i favorizon, pasi kjo mundësi njihet për punonjës me këtë nivel arsimor dhe me arsim në vazhdim, vetëm për institucionet që futen për herë të parë në shërbimin civil, gjë e cila nuk mund të thuhet për Këshillin e Qarkut Durrës.

2. Pozicionet e punës, për të cilat kanë konkuruar këto punonjëse, nuk kanë qënë të lira në kuptim të ligjit, për t’u plotësuar nëpërmjet konkurimit, por kanë qënë pozicione ku më parë ishin të punësuar nëpunës civilë, të cilët ishin liruar nga shërbimi civil dhe kishin kaluar në listë pritje për shkak ristrukturimi. Në një eventualitet të tillë, nëse

për nevoja pune, duheshin plotësuar këto pozicione, atëherë njësia e burimeve njerëzore nuk duhej të kryente pranime të reja në shërbimin civil, pa ezauruar mundësinë e plotësimit të tyre nga lista e pritjes. Nëse për plotësimin e këtyre pozicioneve të lira nuk kishte punonjës në listë pritje, që të përmbushnin kërkesat e veçanta të këtyre pozicioneve, atëhere mund të hapej procedura e rekrutimit nga jashtë, por gjithmonë duke plotësuar kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

Mosplotësimi i këtyre kërkesave ligjore (kriteri arsimor dhe konkurimi për një pozicion që nuk konsiderohet i lirë sipas ligjit), në momentin e lidhjes së marrëdhënies së punës në shërbimin civil, në bazë të nenit 118 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” përbën shkak për pavlefshmëri relative të veprimit administrativ për pranimin në shërbimin civil dhe të akteve që kanë dalë gjatë kryerjes së tij, ku përfshihen akti i emërimit, akti i lidhjes së marrëdhëniesve financiare, etj. Në bazë të nenit 118/2 dhe 119 të ligjit në fjalë, këto veprime administrative kanë prodhuar efektet e një veprimi/akti të rregullt, por duke qënë se vijnë në kundërshtim me ligjin, duhet të urdhërohet që organi administrativ kompetent të revokojë aktin e emërimit dhe njësia e burimeve njerëzore të urdhërojë ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit. Duke qënë se procesi i konkurimit është i rregullt, por ka një mangësi në aspektin e plotësimit të kërkesave ligjore për nivelin arsimor të pozicioneve konkrete që kanë plotësuar këta punonjës, atëhere do të ishte e drejtë që pas revokimit të akteve të emërimit për rastet në fjalë dhe ndërprerjen e marrëdhëniesve të punës, të urdhërohet rregjistrimi i këtyre punonjësve në listën e kandidatëve fitues, të paemëruar ende, e cila është e vlefshme për një periudhë dy vjeçare, duke përfutur nga mundësia që jep kjo listë për emërim të drejtpërdrejtë prej saj, sapo të konstatohet një pozicion i lirë, ku kandidati plotëson kërkesat e veçanta të atij pozicioni.

I njëjti qëndrim, për të njëjtën arsye (*pavarësisht se nuk kanë problemin e mospërmbushjes së kriterit arsimor*), duhet të mbahet edhe për dy punonjësit e tjerë, ***** dhe *****.

Pozicionet e lira, që do të krijohen pas ndërprerjes së marrëdhëniesve të punës, sipas përfundimit të mësipërm, duhet të plotësohen sipas mënyrës dhe rradhës së mëposhtme:

- Fillimisht, do të verifikohet lista e nëpunësve të liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit, duke vlerësuar nëse i plotësojnë kërkesat e përgjithshme e ato të veçanta të pozicioneve të lira dhe nëse gjenden të përshtatshme, të bëhet emërimi nga kjo listë pritje.
- Nëse nuk gjenden kandidatura të përshtatshme nga kjo listë, atëherë, pozicioni i punës i paplotësuar duhet të shpallet pozicion i lirë dhe të plotësohet sipas rregullave të përcaktuara në nenet 22, 23, 24, etj, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

III. Procedura ligjore e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të lirit nga shërbimi civil i nëpunësve që i

është shkurtuar pozicioni i punës për shkak të ristrukturimit të institucionit, koment i ligjor dhe konkluzionet për secilin rast

Sipas përmbajtjes së nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar; Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014 *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”* të Këshillit të Ministrave dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014 *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* të Këshillit të Ministrave, është njësia përgjegjëse ajo që drejton gjithë procesin nga ana ligjore. Ajo krijon komisionin e ristrukturimit dhe ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirin nga shërbimi civil të nëpunësve që i është shkurtuar pozicioni i punës dhe i ka ndryshuar përshkrimi i punës, pas propozimit të bërë nga komisioni i ristrukturimit.

Njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Durrës, bazuar në Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015 *“Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës”*; Vendimin nr. 7, datë 11.02.2015 të Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore *“Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit”*; nenin 50 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar; Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”* të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* të Këshillit të Ministrave, ka filluar zbatimin e procedurave ligjore për lirin e nëpunësve nga shërbimi civil, pozicionet e punës të të cilëve janë suprimuar apo riorganizuar.

Në përgjithësi aktet e lirit të nxjerra nga njësia përgjegjëse në kuadrin e ristrukturimit, nga pikpamja formale, kanë dalë në përputhje me kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”* dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* të Këshillit të Ministrave. Konstatohet, se në gjithë rastet e trajtuara prej njësisë përgjegjëse dhe propozimet e bëra, si për lirin nga shërbimi civil ashtu dhe për propozimet për rrimërim pas ristrukturimit, janë bërë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore, si dhe me cilësitë personale dhe eksperiencën e secilit punonjës e evidentuar në aneksin 1 bashkëlidhur materialit. Theksojmë se, përshkrimet e reja të punës i kanë paraprirë procesit të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Durrës.

Gjithashtu, konstatohet se nga ana e institucionit ka një kuptim të drejtë të nenit 50 pika 3 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”* të Këshillit të Ministrave, në lidhje me Komisionin e Ristrukturimit dhe mënyrën e ndërtimit të tij. Këtë e tregon fakti se në përbërjen e tij është përfshirë vetë Drejtori i Burimeve Njerëzore, Përgjegjësja e Sektorit të Shërbimeve Juridike dhe Drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, si punonjësi me vjetërsi më të madhe në këtë institucion.

Sipas pikës 14 “*Procedura dhe formati i përshkrimit të punës*” të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” të Këshillit të Ministrave, përshkrimet e reja të punës janë diktuar nga ndryshimi i mënyrës së organizimit të Këshillit të Qarkut Durrës, si pasojë e ristrukturimit dhe janë një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave dhe përgjegjësi kryesore të pozicionit të punës, për shkak se duhet vlerësuar pozicioni i punës në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e reja. Si rrjedhojë një numër më i reduktuar nëpunësish civilë do të plotësojnë gjithë detyrimet në funksion të arritjes së misionit për të cilin është krijuar institucioni i këshillit të qarkut.

Procedura e ndjekur nga Komisioni i Ristrukturimit është konform ligjit, pasi në tërësi, janë respektuar të gjitha rregullat dhe kërkesat si të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ashtu dhe të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, pasi vërehet që në gjithë rastet e trajtuara prej tij dhe propozimet e bëra, si për lirin nga shërbimi civil ashtu dhe për propozimet për riemërim pas ristrukturimit, janë bërë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore, si dhe me cilësitë personale dhe eksperiencën e secilit punonjës. Gjithashtu, është përlogaritur dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë në punë sipas pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Aktet e emërimit dhe riemërimit të nëpunësve civilë në pozicione të një kategorie të barabartë ose më të ulët, janë individuale, janë nxjerrë pasi është marrë paraprakisht deklarimi me shkrim i nëpunësit, nëse pranon ose jo detyrën e re, siç përcaktohet përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” të VKM nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*” .

Proceset e punës në këtë institucion disiplinohen nëpërmjet Rregullores së Brendshme të institucionit, të miratuar me Vendimin nr. 4, datë 30.01.2015, në të cilën janë shprehur mjaft qartë detyrat për secilin pozicion pune, por mungojnë kriteret specifike mbi të cilat duhet të rekrutohen, megjithatë kjo nuk ka ndikuar në proces për faktin se janë përshkrimet e pozicioneve të punës të miratuara.

Procesi i ristrukturimit ka qenë i kushtëzuar nga ligji nr.160/2014, “*Për buxhetin e vitit 2015*” dhe në këtë kontekst është dashur të veprohet me shpejtësi për të zbatuar procedurën e ristrukturimit sipas kërkesave ligjore, por dhe duke respektuar të drejtat e nëpunësve civilë të prekur nga procesi. Fillimi dhe përfundimi i procesit në një kohë të shpejtë është dhe shkak i lejimit të parregullsive të karakterit objektiv si pasojë e kuptimit të gabuar të ligjit për shërbimin civil dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në bazë e zbatim të tij. Ky ligj ka një zhvillim dinamik dhe implementimi i tij do të kërkojë kohë dhe trajnime të vazhdueshme të cilat do të jenë të domosdoshme për nëpunësit e Këshillit të Qarkut Durrës.

- *Aktet e lirim të puna të nëpunësve pas ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Durrës, sipas Vendimit nr. 2, datë 30.01.2015, “Për miratimin e strukturës organizative të Administratës të Këshillit të Qarkut Durrës”*

1. ***** - nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues me detyrë “Përgjegjës/Kryeinspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës” (kategoria III-a/1). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 30.09.2011, në pozicionin inspektor, dhe nëpërmjet procedurës sëngritjes në detyrë ka kaluar në pozicionin e mësipërm.
Konstatohet se Akti i Deklarimi i Statusit të Punësimit nr. 781, datë 22.05.2014 si nëpunës civil në periudhë prove është dhënë për pozicionin *Përgjegjës në IMT*.
Me njoftimin e titullarit nr. 92 prot., datë 15.01.2015, është njoftuar se në institucionin e Këshillit të Qarkut Durrës do të realizohet në vijim, procesi i ristrukturimit të institucionit, i cili do të sillte shkurtime të vendeve të punës në administratë. Me strukturën e re të miratuar me Vendiminnr. 2, datë 30.01.2015, pozicioni i punës “Përgjegjës/Kryeinspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës”, **nuk ekziston**,
Ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe lirimi nga shërbimi civil është finalizuar me vendimin nr. 45, (nr. 349prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse. Gjithashtu është llogaritur drejt edhe dëmshpërblimi sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në masën e 3 pagave mujore, në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil

2. ***** - nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, në Sektorin e Personelit dhe Arshivës” (kategoria III-b). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 20.07.2004.
Nëpërmjetaktit administrativnr. 811, datë 26.05.2014, është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil në pozicionin “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, në Sektorin e Personelit dhe Arshivës”.
Me njoftimin e titullarit nr. 92 prot., datë 15.01.2015, është njoftuar se në institucionin e Këshillit të Qarkut Durrës do të realizohet në vijim procesi i ristrukturimit të institucionit, proces i cili do të sjellë shkurtime të vendeve të punës në administratën e institucionit. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, **nuk ekziston më**.
Me vendimin nr. 15, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar lirimi nga shërbimi civil dhe me vendimin nr. 43, (nr. 342 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 12 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

3. ***** - nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “Specialistee Shërbimeve Publike në Sektorin e Shërbimeve Rajonale” (kategoria III-b). Ka filluar punë pranë

Këshillit të Qarkut Durrës në datë 01.10.2009, si specialiste mjedisi. Në pozicionin aktual ka kaluar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 797, datë 23.05.2014 është dhënë në nivelin nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist i Shërbimeve Publike në Sektorin e Shërbimeve Rajonale*”.

Në përfundim të procesit të ristrukturimit, në zbatim të strukturës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, pozicioni “*Specialist i Shërbimeve Publike në Sektorin e Shërbimeve Rajonale*”, **nuk ekziston më**.

Për këtë shkak, me shkresën nr. 146 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 54, (nr. 358 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse, është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 6 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punësi nëpunës civilsipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

4. ***** - nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë “*Specialiste për Administrimin e Rregjistrimit të Territorit në Sektorin e Urbanistikës*” (kategoria III-b), ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 12.05.2003 (sipas librezës së punës).

Akti i Deklarimit të statusit të punësimit nr. 785, datë 22.05.2014 është dhënë në nivelin nëpunës civil, në pozicionin “*Specialist për Administrimin e Rregjistrimit të Territorit në Sektorin e Urbanistikës*”.

Në përfundim të procesit të ristrukturimit, në zbatim të strukturës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, pozicioni “*Specialist për Administrimin e Rregjistrimit të Territorit në Sektorin e Urbanistikës*”, **nuk ekziston më**.

Me vendimin nr. 31, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 59, (nr. 363 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 12 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civilsipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

*****, duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

5. ***** - nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv, me detyrë “*Specialiste e Menaxhimit të Shpenzimeve në Sektorin e Financës*” (kategoria III-b) ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 17.02.2003.

Akti i Deklarimit të statusit të punësimit nr. 793, datë 23.05.2014, është dhënë në nivelin nëpunës civil, në pozicionin “*Specialiste e Menaxhimit të Shpenzimeve në Sektorin e Financës*”.

Në përfundim të procesit të ristrukturimit, në zbatim të strukturës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, pozicioni "*Specialiste e Menaxhimit të Shpenzimeve në Sektorin e Financës*", **nuk ekziston më.**

Nisur nga kjo, me Vendimin nr. 14, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 42, (nr. 346 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 12 pagave mujore, në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar. ***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

6. ***** - nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv, me detyrë "*Specialiste e Marrëdhënieve me Ekzekutivin në Sektorin e Shërbimeve Juridike*" (kategoria III-b), ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 09.02.2001.

Akti i Deklarimit të statusit të punësimit nr. 807, datë 26.05.2014, është dhënë në nivelin nëpunës civil, në pozicionin "*Specialiste e Marrëdhënieve me Ekzekutivin në Sektorin e Shërbimeve Juridike*".

Në përfundim të procesit të ristrukturimit, në zbatim të strukturës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, pozicioni "*Specialiste e Marrëdhënieve me Ekzekutivin në Sektorin e Shërbimeve Juridike*" **nuk ekziston më.**

Nisur nga kjo, me vendimin nr. 28, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 56, (nr. 360 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse, është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 12 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar. ***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

7. ***** - nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë "*Specialist i Investimeve Publike në Sektorin e Shërbimeve Rajonale*" (kategoria III-b), ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 17.05.2010.

Akti i Deklarimit të statusit të punësimit nr. 796, datë 23.05.2014, është dhënë në nivelin nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin "*Specialist i Investimeve Publike në Sektorin e Shërbimeve Rajonale*", për shkak se konkurrimi është zhvilluar në Qershor të 2013 dhe në atë kohë nuk ishte përmbushur afati 1 vjeçar, i provës.

Në përfundim të procesit të ristrukturimit, në zbatim të strukturës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, pozicioni “*Specialist i Investimeve Publike në Sektorin e Shërbimeve Rajonale*”, **nuk ekziston më.**

Nisur nga ky fakt, me shkresën nr. 146 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit, është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 53, (nr. 357 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 3 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm, ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

8. ***** - nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist i Marrëdhënieve me Gjyqësorin në Sektorin e Shërbimeve Juridike*” (kategoria III-b); ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 01.04.2010. Akti i Deklarimit të statusit të punësimit nr.808, datë 26.05.2014 është dhënësi nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin *Specialist i Marrëdhënieve me Gjyqësorin në Sektorin e Shërbimeve Juridike*, për shkak se konkurrimi është zhvilluar në qershor të 2013 dhe në momentin e dhënies së aktit të deklarimit të statusit, akoma nuk ishte plotësuar afati i provës.

Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, **nuk ekziston më.**

Me vendimin nr. 27, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 55 (nr. 359 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 3 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar.

9. ***** - nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv, me detyrë “*Specialist e Zhvillimit të Mjedisit në Sektorin e Zhvillimit të Mjedisit*” (kategoria III-b); ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 17.02.2003. Akt Deklarimi i statusit të punësimit nr. 790, datë 23.05.2014 si nëpunës civil, në pozicionin “*specialist në sektorin e koordinimit, hartimit dhe zbatimit të projekteve*”, pozicion i krijuar sipas strukturës të miratuar me vendimin nr. 16, datë 03.05.2013, “*Për disa ndryshime në vendimin nr. 153, datë 10.02.2012 të strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës*”. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, **nuk ekziston më.**

Me vendimin nr. 22, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 50, (nr. 354 prot.) datë 12.02.2015 të Njesisë Përgjegjëse është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja

e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 12 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

10. ***** - nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist i Planifikimit të Territorit në Sektorin e Urbanistikës*” (kategoria III-b). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 16.09.2010. Akt Deklarimi i statusit të punësimit nr. 784, datë 22.05.2014 si nëpunës civil në pozicionin “*Specialist i Planifikimit të Territorit në Sektorin e Urbanistikës*”.

Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, **nuk ekziston më.**

Me vendimin nr. 32, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 60, (nr. 364 prot.) datë 12.02.2015 të Njësisë Përgjegjëse është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 6 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

11. ***** - nëpunëse civile e nivelit të mesëm drejtues, me detyrë “*Drejtor i drejtorisë së Koordinimit të Politikave të Qarkut*” (kategoria II-b). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 16.05.2005. Akt Deklarimi i statusit të punësimit nr. 788, datë 23.05.2014 si nëpunës civil në pozicionin *Drejtor i Koordinimit të Politikave të Qarkut*.

Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, **nuk ekziston më.**

Me vendimin nr. 34, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 62, (nr. 366 prot.) datë 12.02.2015 të Njësisë Përgjegjëse është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 12 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

12. ***** - nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv, me detyrë “*Inspektor në IMT*” (kategoria III-b). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 09.02.2001. Akt Deklarimi i statusit të punësimit nr. 782, datë 22.05.2014 si nëpunës civil në pozicionin *Inspektor*.
Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, **nuk ekziston më**.
Me vendiminnr. 19, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 47, (nr. 351 prot.,) datë 12.02.2015 të Njësisë Përgjegjëse është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 12 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar.
***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.
13. ***** - nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist Jurist në Sektorin e Urbanistikës*” (kategoria III-b). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 27.02.2009. Akti ideklarimit të statusit të punësimit nr. 780, datë 22.05.2014 si nëpunës civil është dhënë për pozicionin *specialist në drejtorinë e planifikimit të territorit dhe shërbimeve rajonale*, pozicion i krijuar sipas strukturës të miratuar me vendimin nr.16, datë 03.05.2013, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 153, datë 10.02.2012 të strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”.
Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, **nuk ekziston më**.
Me vendiminnr. 33, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 61, (nr. 365 prot.,) datë 12.02.2015 të Njësisë Përgjegjëse është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 12 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.
14. ***** - nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues me detyrë “*Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve*” (kategoria II-b). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 08.02.2001. Akt deklarimi i statusit të punësimit nr. 791, datë 23.05.2014 si nëpunës civil në periudhë prove për shkak të ngritjes në detyrë nga pozicioni përgjegjës i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Juridike ka kaluar në pozicionin drejtor i kësaj drejtorie, e cila është krijuar sipas strukturës të miratuar me vendimin nr. 16, datë

03.05.2013, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 153, datë 10.02.2012 të strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”.

Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, **nuk ekziston më.**

Me vendiminnr. 12, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 40, (nr. 344 prot.,) datë 12.02.2015 të Njësisë Përgjegjëse është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 12 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

15. ***** - nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist i Arshivës Digjitalë në Sektorin e IT dhe Statistikave*” (kategoria III-b). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 06.06.2013. Akt Deklarimi i statusit të punësimit nr. 810, datë 26.05.2014 si nëpunës civil në periudhë prove, pozicion i krijuar sipas strukturës të miratuar me vendimin nr.16, datë 03.05.2013, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 153, datë 10.02.2012 të strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Durrës”.

Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, **nuk ekziston më.**

Me vendiminnr. 16, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 44, (nr. 348 prot.,) datë 12.02.2015 të Njësisë Përgjegjëse, është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 3 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

16. ***** - nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Inspektor në IMT*” (kategoria III-b). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 21.04.2014 me kontratë.

Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, **nuk ekziston më.**

Megjithëse ky punonjës nuk duhet të ishte trajtuar si nëpunës civil, për shkak se marrëdhëniet financiare kanë filluar pas hyrjes në fuqi të ligjit, me vendiminnr. 18, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 46, (nr. 350 prot.,) datë 12.02.2015 të Njësisë Përgjegjëse, është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 1 paga mujore në

përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

***** nuk është rekrutuar sipas procedurave të shërbimit civil.

***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

17. ***** - nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv, me detyrë “*Specialiste e Menaxhimit të Ardhurave*” (kategoria III-b). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 09.02.2001. Akt Deklarimi i statusit të punësimit nr. 794, datë 23.05.2014 si nëpunëse civile. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.201, **nuk ekziston më.**

Me vendimin nr. 13, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 41, (nr. 345 prot.) datë 12.02.2015 të Njësisë Përgjegjëse, me të drejtë është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 12 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

18. ***** - nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, me detyrë “*Inspektor në IMT*” (kategoria III-b). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Durrës në datë 14.05.2008. Më pas me Vendimin nr. 42, datë 16.12.2013 i jepet masa disiplinore largim nga shërbimi civil. Rikthehet në detyrë në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës me nr. 308, datë 31.03.2014 dhe vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit me nr. 4447, datë 04.11. 2014 në pozicionin *Specialist për Koordinimin e Politikave Sociale dhe Barazinë Gjinore* në Sektorin e Hartimit, Koordinimit dhe Zbatimit të Projekteve. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, **nuk ekziston më.**

Me vendimin nr. 29, datë 11.02.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 57, (nr. 361 prot.) datë 12.02.2015 të Njësisë Përgjegjëse, me të drejtë është vendosur lirimi nga shërbimi civil dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu është vendosur dhënia e dëmshpërblimit në masën e 9 pagave mujore në përputhje me vjetërsinë e punës si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 7 të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës një kërkesë-padi, e cila është në proces gjykimi.

IV. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil

Ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (Kreu XI, neni 62), përcakton detyrimin e institucioneve për të vlerësuar punën e çdo punonjësi që kryen funksione në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Vlerësimi i performancës ka pasoja të rëndësishme për një nëpunës civil në disa drejtime, ndër të cilat, konfirmimi i tij gjatë periudhës së provës, ndërprerja e marrëdhënies së punës pas dy vlerësimeve të njëpasnjëshme negative, ka rol vendimtar në sistemin e karrierës, pasi favorizon lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë, si dhe luan një rol të rëndësishëm për risistemimin e nëpunësit në një rast ristrukturimi.

Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj (*pika 1, neni 62*).

Përveç vlerësimit, sipas paragrafit të mësipërm, nëpunësit vlerësohen periodikisht, sipas përcaktimeve me Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të Këshillit të Ministrave, edhe për përfitim dhe përditësimin e njohurive shtesë të nevojshme për realizimin e funksioneve të tyre, në përputhje me kategorinë/grupin e administrimit të përgjithshëm/posaçëm ku bëjnë pjesë.

Në çdo rast, procesi i vlerësimit të kryer sipas kësaj pike, duhet të garantojë anonimatit e nëpunësit civil të vlerësuar.

Nëpunësi mund të vlerësohet në një nga këto nivele:

- a)** “shumë mirë” (1);
- b)** “mirë” (2);
- c)** “kënaqshëm” (3);
- ç)** “jokënaqshëm” (4).

Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë: **a)** është procesi vjetor i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave; **b)** shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirimimin nga shërbimi civil, përparimin në hapat e pagës, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që përsëritet çdo vit. Viti i vlerësimit është i njëjtë me vitin kalendarik. Në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, viti i vlerësimit llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil.

Sa më sipër, ç`ka pasqyrojnë rregullime të posaçme të parashikuara shprehimisht në ligjin dhe aktet nënligjore që disiplinojnë fushën e shërbimit civil në lidhje me këtë institut të rëndësishëm,

janë mbajtur parasysh nga njësia përgjegjëse, e cila ka si detyrim ligjor drejtimin e këtij procesi dhe koordinimin e punëve me të gjithë pjesmarrësit në këtë proces.

Vlerësimi i rezultateve në punë është një proces i vështirë që kërkon punë sistematike dhe të materializuara në shënime sistematike, nominale nga ana e punonjësve të ngarkuar me implementimin e tij, të cilët paraqiten në rolin e Zyrtarit Autorizues dhe Kundërfirmues, për nëpunësit civil në pozicionin që i përket shërbimit civil.

Konkluzion:

Pas kontrollit të ushtruar në lidhje me procesin e vlerësimeve vjetore të nëpunësve, në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil" Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstatoi se, vlerësimet e rezultateve individuale në punë, për periudhën 2013 – 2014, të gjithë nëpunësit civil të Këshillit të Qarkut Durrës ishin vlerësuar me nivelin 1 "shumë mirë" dhe 2 "mirë", gjë që pavarësisht vështirësisë për të matur nga jashtë saktësinë dhe eficiencën e akteve të kësaj natyre të eprorit, tregon për elemente të një qëndrim subjektiv dhe formal. Kjo tregon që punonjësit janë vlerësuar sipas legjisllacionit të shërbimit civil, është zbatuar neni 62 i ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil", gjë e cila flet për një qëndrim të kujdesëshëm nga ana formale, në kryerjen e detyrës si nga njësia e personelit ashtu dhe nga ana e eprorëve direkt. Në këtë rast kemi të bëjmë me një detyrim ligjor të plotësuar, i cili krijon kushtet ligjore, për funksionimin e sistemit dhe elementëve të shërbimit civil, si psh, në rastet kur nëpunësi civil mund të jetë i interesuar të bëjë lëvizje paralele, apo të kërkojë zhvillimin e karrierës, nëpërmjet procedurave të ngritjes në detyrë, etj.

V. Përmbajtja dhe administrimi i dosjeve të personelit dhe Rregjistri i Personelit

a. Dosja e Personelit

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës verifikoi dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administruar në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se janë të përfshira dokumenta me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit të Ministrave, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se në çdo dosje janë të administruara dokumentat e identifikimit (fotokopje e pasaportës); vërtetimin e gjendjes gjyqësore (akt i vitit 2014); dokumenta që tregojnë për gjendjen civile (çertifikata e gjendjes familjare); dokumenta që vërtetojnë edukimin arsimor (diploma e shkollës së lartë); dokumenta që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (akti i emërimit); akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (çertifikata kualifikimi), etj.

Plotësimi i këtyre kërkesave është pasqyruar në mënyrë të detajuar në *Aneksin nr. 1* që është pjesë e këtij materiali.

b. Rregjistri i personelit

Regjistri i personelit është një dokument i krijuar sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Në kushtet kur, ende nuk është bërë funksional Regjistri Qendror i Personelit, që administrohet nga Departamenti i Administratës Publike, në një mënyrë specifike sipas përcaktimeve të bëra në një akt nënligjor të veçantë, rezulton se të dhënat që përmban regjistri i institucionit, pasqyrojnë gjëndjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

Konkluzion:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstatoi se, dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Specialisti i Burimeve Njerëzore, që është nëpunës përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

*
* *

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e administrimit të shërbimit civil, janë materializuar në tabelat si më poshtë:

- ***Aneksi 1*** - “Respektimi i kërkesave të përgjithëshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion”.
- ***Aneksi 2*** - “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimitcivil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të punësuar nëpërmjet konkurimit (data 26.02.2014)”.
- ***Aneksi 3*** - “Organigrama dhe historiku i marrëdhënies me shërbimin civil të punonjësve të Këshillit të Qarkut Durrës”.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA